

**KONTRATË  
PËR  
REALIZIMIN E PRAKTIKËS PROFESIONALE**

**Lidhur sot në \_\_\_\_\_, më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_\_, midis palëve;**  
**1. Z/Znj. \_\_\_\_\_, Drejtues/e Teknik/e // i/e Punësuar tek**  
**Farmacit \_\_\_\_\_, me adresë \_\_\_\_\_,**  
**që këtej e tutje do njihet si “DREJTUESI I PRAKTIKËS”**

**DHE**

**2. Z/Znj. \_\_\_\_\_, praktikanti/e me Nr. \_\_\_\_\_**  
**Diplome, datë \_\_\_\_\_ dhe adresë banimi \_\_\_\_\_.**  
**që këtej e tutje do njihet si “PRAKTIKANTI”**

**BAZA LIGJORE**

Kjo kontratë hartohet ne mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 « Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë », i ndryshuar, Ligjit nr. 10 171 Datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbështetur në vullnetin e tyre të lirë të dyja palëve, ranë dakord si me poshtë ;

**Neni 1**

**Objekti i Kontratës**

Objekt i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve që lindin për Drejtuesin e Praktikës dhe Praktikantin gjatë periudhës së kryerjes së praktikës.

**Neni 2**

**Afati i Kontratës**

Afati i kontratës dhe hyrja ne fuqi e saj fillon nga data e nënshkrimit te saj nga palët dhe përfundon vlefshmërinë e saj me përfundimin e Praktikës Profesionale pranë “Drejtuesit të Praktikës”.

Afati i kontratës fillon në datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/20\_\_\_\_ dhe përfundon në datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/20\_\_\_\_.

**Neni 3**

**Përshkrimi i Veprimtarisë**

Kontrata e praktikës lidhet midis farmacist/e \_\_\_\_\_ i/e cili/a do të jetë në rolin e Drejtuesit të Praktikës Profesionale dhe praktikantit/es

\_\_\_\_\_, me qëllim përgatitjen praktike të praktikantit për përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit nga ana e tij, në përputhje të plotë me programin e praktikës. Kontrata garanton të drejtat dhe detyrimet e Drejtuesit të Praktikës për të dhënë eksperiencën e tij, duke respektuar parimin e lirisë kontraktuese, të barazisë dhe të respektimit të drejtë dhe të paanshëm të interesave të palëve.

Oraret e zhvillimit të Praktikës do të jenë 6 (gjashtë) orë në ditë, 08:00 – 14:00, 5 ditë në javë (E hënë – E premte)

Drejtuesi i Praktikes në përfundim të praktikës bën vlerësimin e njohurive praktike të praktikantit duke plotësuar “Formularin e Vlerësimit” si dhe lëshon vërtetimin për përfundimin e praktikës.

#### **Neni 4**

##### **Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve**

-

##### **Të drejtat dhe detyrimet e Drejtuesit të Praktikës**

1. Të jetë profesionist me përvojë jo më pak se 3 (tre) vjetësh.
2. Ti sigurojë Praktikantit kushtet e nevojshme për realizimin e një praktike efektive.
3. Ti bëjë një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm njohurive të Praktikantit dhe të pajisë praktikantin me Formularin e Vlerësimit të Praktikës.
4. Të drejtojë praktikën profesionale në përputhje të plotë me standardet, parimet dhe normat e Kodit Deontologjik Farmaceutik, si dhe me legjislacionin farmaceutik në fuqi.
5. Ti kërkojë praktikantit respektimin e orarit dhe ta dokumentojë atë në librezën e praktikës profesionale.
6. Ti kërkojë Praktikantit kryerjen e praktikës profesionale në përputhje me rregulloren e UFSH për praktikën profesionale.
7. Të anulojë kontratën në rast shkeljeje të detyrimeve të saj nga ana e praktikantit dhe të njoftojë strukturat më të afërta të UFSH-së.

##### **- Të drejtat dhe detyrimet e Praktikantit**

1. Të respektojë Drejtuesin e Praktikës në përputhje të plotë me normat e etikës dhe kodit deontologjik farmaceutik.
2. Të qëndrojë në farmacinë ku kryen praktikën gjatë gjithë periudhës së praktikës, të respektojë orarin e caktuar dhe të pranojë në fund të praktikës vlerësimin e bërë nga Drejtuesi i Praktikës. Praktika është program i detyrueshëm mësimor.
3. Të respektojë Drejtuesin e Praktikës dhe etikën e komunikimit me të dhe me pacientët.
4. Ankohet tek drejtuesi i institucionit si dhe tek strukturat më të afërta të UFSH-së për veprime që bien ndesh me këto të drejta apo tjetër veprim që e pengon, krijon vështirësi apo pamundësi në zhvillimin efektiv të praktikës.

5. Praktikanti që fiton të drejtën e anulimit të kontratës ekzistuese, për periudhën e mbetur nënshkruan kontratë me një drejtues tjetër praktike.

## **Neni 5**

### **Te ndryshme**

1. Kjo kontratë është një marrëveshje midis Drejtuesit të Praktikës dhe Praktikantit në lidhje me realizimin e periudhës së praktikës.
2. Shpërblimi financiar reciprok përcaktohet në një marrëveshje tjetër dypalëshe.
3. Palët duhet të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë si rrjedhojë e zbatimit të kësaj kontrate.
4. Kontrata hartohet tre kopje me fuqi të njëjtë ligjore, nga të cilat një për secilën palë dhe një depozitohet në Urdhrin e Farmacistëve.
5. Palët e lexojnë dhe pasi pranojnë e bien dakord me kushtet e kësaj kontrate, e nënshkruajnë atë, në dhe për interes të qëllimeve profesionale që përfaqësojnë.

**DREJTUESI I PRAKTIKËS**

---

**PRAKTIKANTI**

---